



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT  
OPSHTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

DATE/A	03.05.2017
REFERENC-Ë :	
PËR/ZA/TO:	z. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunes se Lipjanit
CC:	z. Sefer Tasholli, Nenkryetar i Komunes se Lipjanit
NGA/OD/FROM:	Shkelzen Hajdini, Drejtor i Drejtoratit per Buxhet dhe Financa
TEMA/SUBJEKAT/ SUBJECT:	Raport Mujor 01.04.2017 -30.04.2017

Ky raport përfshinë të dhënat mujore nga sektorët e Drejtoratit për Buxhet dhe Financa si: Sektori i Buxhetit dhe Financave, Sektori i Thesarit dhe Sektori i Tatimit në Pronë.

### **Sektori i Buxhetit dhe Financave**

Drejtorati për Buxhet dhe Financa ka njoftuar secilin autorizues të programeve për pjesën e dytë të buxhetit të alokuar nga granti qeveritar. Poashtu, autorizuesit e programeve janë njoftuar për gjendjen buxhetit të programeve për të cilat janë të autorizuar dhe shpenzimet gjatë kësaj periudhe raportuese.

Për shkak të mosfunksionimit të Asamblesë Komunale, ende nuk është aprovuar Rritja e Buxhetit për Vitin 2016, në vlerë prej 158,066.01€, dhe nuk është bërë bartja e të hyrave nga vitet paraprake në vlerë prej 757,608.27€ në vitin buxhetor 2017.

Vonesa e bartjes së të hyrat në këtë vit buxhetor do të ketë ndikim të drejteperdrejtë në menaxhimin dhe performancën financiare të organizatës sonë buxhetore. Kjo do të ndikoj në uljen e përqindjes së shpenzimit të buxhetit të krijim të obligimeve financiare për një kohë të caktuar.

Për shkak të aplikimit të kodit pesëshifrorë, programet janë ballafaquar me probleme gjatë inicimit të kërkesave dhe drejtorati për buxhet dhe financa ka pasur vështësi gjatë shpenzimit të buxhetit.

Bazuar në Ligjin mbi Buxhetin për vitin 2017, ne kemi dorëzuar në Ministrinë e Financave kërkesën për Rialokim të Mjeteve deri në 25% të kategorive të afektuara.

Shpenzimi i buxhetit të planifikuar gjatë kësaj periudhe është 23.98 % ndërsa, në bazë të alokimit të mjetëve është 54.08%. Niveli i ulët i shpenzimit të buxhetit sidomos në mallra e shërbime dhe kapitale është si pasojë e mos bartjes së të hyrave nga viti i kaluar ku edhe kanë ndodhur shpenzimet. Shpenzimet e paraqitura në formë tabelare:

Buxheti i planifikuar në krahasim me shpenzimin:

PËRSHKRIMI	Shuma e Alokuar	Shpenz. buxhetit	Obligimet	Zotimet	Te lira	%
11 RROGA DHE PAGA	8,772,802.03	2,884,713.93	0.00	0.00	5,888,088.10	32.88
13 MALLRA DHE SHËRBIME	856,370.35	128,172.86	14,863.42	52,844.09	660,489.98	14.97
14 SHPENZIME KOMUNALE	198,390.00	67,671.44	3,490.16	0.00	127,228.40	34.11
20 SUBVENC. DHE TRANSFERE	329,067.00	59,905.00	0.00	0.00	269,162.00	18.20
30 PASURITË JOFINANCIARE	3,949,836.21	241,740.64	29,058.23	1,788,645.69	1,890,391.65	6.12
<b>Totali I Përgjithshëm:</b>	<b>14,106,465.59</b>	<b>3,382,203.87</b>	<b>47,411.81</b>	<b>1,841,489.78</b>	<b>8,835,360.13</b>	<b>23.98</b>

Buxheti i alokuar në krahasim me shpenzimin:

PËRSHKRIMI	Shuma e Alokuar	Shpenz. buxhetit	Obligimet	Zotimet	Te lira	%
11 RROGA DHE PAGA	2,884,713.93	2,884,713.93	0.00	0.00	0.00	100.00
13 MALLRA DHE SHËRBIME	646,347.83	128,172.86	14,863.42	52,844.09	450,467.46	19.83
14 SHPENZIME KOMUNALE	117,757.00	67,671.44	3,490.16	0.00	46,595.40	57.47
20 SUBVENC. DHE TRANSFERE	102,000.00	59,905.00	0.00	0.00	42,095.00	58.73
30 PASURITË JOFINANCIARE	2,503,818.26	241,740.64	29,058.23	1,788,645.69	444,373.70	9.65
<b>Totali I Përgjithshëm:</b>	<b>6,254,637.02</b>	<b>3,382,203.87</b>	<b>47,411.81</b>	<b>1,841,489.78</b>	<b>983,531.56</b>	<b>54.08</b>

Gjatë kësaj periudhe janë zotuar 141 lëndë nga drejtoratet në shumë prej 66,051.66 prej të cilave 76 lëndë në shumë prej 20,555.63€, i përkasin kategorisë së mallrave dhe shërbimeve, 20 lëndë në shumë prej 16,830.00€ të kategorisë subvencione dhe transfere, 44 lëndë në shumë prej 6,391.03€ nga shërbimet komunale dhe 1 lëndë në shumë prej 22,275.00€ janë zotuar në kategorinë investime kapitale.

Gjatë muajit Prill kemi bashkëpunuar ngushtë me auditorët e Zyrës Kombëtare të Auditimit të cilën kanë bërë auditimin e Pasqyrave financiare të komunës sonë për vitin 2016.

Me qëllim të nxjerrjes së raporteve të sakta mbi shpenzimin e buxhetit, të hyrat dhe pasuritë komunale, në dy mbledhjet e fundit të bordit të drejtorëve është kërkuar shfrytëzimi i plotë i programit për menaxhimin financiar dhe është komunikuar së të gjitha procedurat e kryerjes së shpenzimit duhet të kalojnë përmes këtij sistemi. Nga menaxheri i kontratës është kërkuar implementimi i plotë i këtij programi dhe raportimi i rregullt mbi shfrytësimin e këtij sistemi elektronik nga personat e autorizuar.

Bazuar në Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullat Financiare, ZKF-ja ka bërë raportimin e rregullt të obligimeve financiare për muajin Prill dhe obligimet e mëparshme në Ministrinë e Financave respektivisht në Thesarin Qendror.

**Të hyrat e inkasuara gjatë kësaj periudhe raportuese (Prill) janë 118,058.11€.**

Totali i të hyrave të inkasuara deri më 30.04.2017 është 447,661.16€. Ky trend është pozitiv; mirëpo, marrë parasyshë tavanin e lartë të planifikimit të të hyrave vetanake në shumë prej 2,108,545.00€, ky trend i inkasimit të të hyrave nuk premtion financimin e shpenzimeve të parapara me planifikim të buxhetit. Ndikim të drejteperdrejtë mund të ketë tek disponueshmëria e mjeteve për projektet kapitale dhe mund të shkaktoj vonesa në iniciimin e procedurave të prokurimit dhe sigurimit të fondeve për zotimin e mjeteve për projektet kapitale të fiancuara nga të hyrat vetanake.

Gjatë procesit të Rishikimit, nëse vazhdon ky trend i inkasimit, ekzekutivi dhe legjislativi duhet të konsiderojnë mundësinë e rishikimit të kategorisë së investimeve kapitale dhe mjetet e mbetura nga projektet e kontraktuara të destinohen për financim të disa projekteve kapitale të planifikuara të financohen nga të hyrat vetanake.

Drejtori për Buxhet dhe Financa ka kërkuar nga Sektori i Tatimit ne Prone nxjerrjen e listave të tatimpaguesëve të cilët nuk i kanë përmbushur obligimet. Është kërkuar të nxjerren listat e punëtorëve të administratës, zyrës së kryetarit dhe stafit politik, punëtorëve të administratës së arsimit dhe gjendja per secilen shkollë, shëndetësisë.

Këto lista do të publikohen në webfaqe të komunës dhe borgjlinjët do të kontaktohen nga inkasanti i tatimit në pronë.

Poashtu, Drejtori për Buxhet dhe Financa ka kërkuar nga Sektori i Tatimit në Pronë nxjerrjen e listës së borgjlinjëve të mëdhenjë dhe inicimin e vërejtjeve të para. Më tutje, është kërkuar që inkasati të kontaktoj secilin borxhli dhe të komunikoj dobinë dhe mekanizmat e Komunës së Lipjanit të mundësuar me Ligjin mbi tatimin në pronë për vjeljen e tatimit.

Në fund, nga ekipi i TP është kërkuar që qdo tatimpaguesi të i komunikohet Ligji për Faljen e Borgjëve dhe të motivohen borgjlinjët të shfrytezojnë këtë mundësi.

Realizimi i të Hyrave Vetanake, deri me 30.04. 2017, në krahasim me vitin e kaluar ka tejkalim 2.66%.

#### Planifikimi dhe realizimi i të Hyrave Vetanake 2017- Lipjan Janar-Prill

Kodet Ekonomike	Planifikimi 2017	Realizimi 2017	indeksi	%
<b>16303 - ADMINISTRATA-LIPJAN</b>				
50013 - TAX CERTIFIKATAT E LINDJES	30,500.00	3,242.00	10.63	-89.37
50014 - TAX CERTIFIKATAT E KURORIZIMIT	3,500.00	1,537.50	43.93	-56.07
50015 - TAX CERTIFIKATAT E VDEKJES	1,500.00	302.00	20.13	-79.87
50016 - TAX CERTIFIKATA TJERA	24,500.00	10,056.00	41.04	-58.96
50019 - TAX TJERA ADMINISTRATIVE	10,000.00	2,506.50	25.07	-74.94
50403 - TE HYRAT NGA SHITJA E MALLRAVE	8,000.00	680.05	8.50	-91.50
50019- QENDRA PER SHERBIME SOCIALE		0.00		
50107 - GJOBAT TJERA	500.00	4,001.00	800.20	700.20
<b>16715 - PROKURIMI</b>		0.00		
50020 - TAX E PJESMARJES NË TENDER	700.00	0.00	0.00	-100.00
<b>17503 - BUXHETIMI-LIPJAN</b>		0.00		
50002 - TAX RRUGORE	150,000.00	28,475.00	18.98	-81.02
40110 - TATIMI NË PRONË	755,000.00	166,997.12	22.12	-77.88
<b>48003 - PLANIF.ZHV.EKONOM-LIPJAN</b>		0.00		
50290 - LIC.TJERA PËR AFARIZËM	25,000.00	0.00	0.00	-100.00
50408 - QIRAJA NGA OBJEKTET PUBLIKE	74,100.00	9,712.82	13.11	-86.89
<b>16605 - INSPEKSIONI-LIPJAN</b>		0.00		
50104 - GJOBAT MANDTORE	500.00	170.00	34.00	-66.00
50205 - LIC.PRANIM TEKNIK TE LOKALIT	6,000.00	1,825.00	30.42	-69.58
<b>65015 - SHËRBIMET KADASTRALE-LIPJAN</b>		0.00		
50017 - TAX VERIFIKIM DOK.TË NDRYSHME	35,000.00	19,400.00	55.43	-44.57
50011 - TAX REGJISTRIMIN E TRASHIGIMIS	64,500.00	14,184.00	21.99	-78.01
50504 - TAX PER MATJEN TOKES NE TEREN	40,000.00	8,204.60	20.51	-79.49
<b>66320 - PLANIF.URBAN.INSPEKC.-LIPJAN</b>		0.00		
50009 - TAX PËR LEJE NDËRTIMI	297,000.00	106,283.77	35.79	-64.21
50013 TAX NDERRIMI DESTINIMI I TOKES	60,000.00	16,345.00	27.24	-72.76
50026 - TAX PER LEGALIZIMIN E OBJEKTE.	240,000.00	0.00	0.00	-100.00
-TAX PER LEJE MJEDISORE	10,000.00	3,782.50	37.83	-62.18
<b>18163 - INFRASTRUKTURA PUBLIKE</b>		0.00		
50405 - SHFRYTEZIMI I PRONES PUBLIKE	5,000.00	940.00	18.80	-81.20
50406 - PRONA PUB.PER TREG.TE HAPUR	40,000.00	12,318.80	30.80	-69.20
<b>85003 - SHËRBIMET KULTURORE-LIPJAN</b>		0.00		
50019 - TAX TJERA ADMINISTRATIVE (RHIVA)	1,100.00	94.00	8.55	-91.45
50408 - QIRAJA NGA OBJEKTET PUBLIKE	500.00	0.00	0.00	-100.00
<b>GJITHESEJT I:</b>	<b>1,882,900.00</b>	<b>411,057.66</b>	<b>21.83</b>	<b>-78.17</b>

92250 - ARSIMI PARAFI & QERDHJA-LIPJAN	30,000.00	10,610.00	35.37	-64.63
73200 - SHËRBIMET E KUJDESIT PRIMAR SHËNDETESIA 73200- 50409	45,000.00	9,828.50	21.84	-78.16
50403 - TE HYRAT NGA SHITJA E MALLRAVE (PARTICIPIM) A.GLLAVICA	30,000.00	1,035.00	3.45	-96.55
50408 - QIRAJA NGA OBJEKTET PUBLIKE	400.00	0.00	0.00	-100.00
50409- SHKOLLA E MESME ULIPIANA		10.00		
<b>GJITHESEJT II:</b>	<b>1,988,300.00</b>	<b>432,541.16</b>	<b>21.75</b>	<b>-78.25</b>
GJOBAT E TRAFIKUT	30,000.00	10,060.00	33.53	-66.47
GJOBAT E GJYKATES	90,000.00	5,060.00	5.62	-94.38
AGJENCIONI I PYJEVE	247.00	0.00	0.00	-100.00
<b>GJITHESEJT III:</b>	<b>2,108,547.00</b>	<b>447,661.16</b>	<b>21.23</b>	<b>-78.77</b>
DONACIONET		58,683.00		
<b>GJITHESEJT IV:</b>	<b>2,108,547.00</b>	<b>506,344.16</b>	<b>24.01</b>	<b>-75.99</b>

Kodet Ekonomike	Realizimi 2016	Realizimi 2017	indeksi	%
<b>16303 - ADMINISTRATA-LIPJAN</b>				
50013 - TAX CERTIFIKATAT E LINDJES	7,247.00	3,242.00	44.74	-55.26
50014 - TAX CERTIFIKATAT E KURORIZIMIT	693.25	1,537.50	221.78	121.78
50015 - TAX CERTIFIKATAT E VDEKJES	226.00	302.00	133.63	33.63
50016 - TAX CERTIFIKATA TJERA	6,349.00	10,056.00	158.39	58.39
50019 - TAX TJERA ADMINISTRATIVE	3,332.00	2,506.50	75.23	-24.77
50403 - TE HYRAT NGA SHITJA E MALLRAVE	0.00	680.05		
50019- QENDRA PER SHERBIME SOCIALE	0.00	0.00		
50107 - GJOBAT TJERA	330.00	4,001.00	1,212.42	1,112.42
<b>16715 - PROKURIMI</b>	0.00			
50020 - TAX E PJESMARJES NË TENDER	0.00	0.00		
<b>17503 - BUXHETIMI-LIPJAN</b>	0.00			
50002 - TAX RRUGORE	29,570.00	28,475.00	96.30	-3.70
40110 - TATIMI NË PRONË	178,863.08	166,997.12	93.37	-6.63
<b>48003 - PLANIF.ZHV.EKONOM-LIPJAN</b>	0.00			
50290 - LIC.TJERA PËR AFARIZËM	0.00	0.00		
50408 - QIRAJA NGA OBJEKTET PUBLIKE	9,215.52	9,712.82	105.40	5.40
<b>16605 - INSPEKSIONI-LIPJAN</b>	0.00			
50104 - GJOBAT MANDTORE	0.00	170.00		
50205 - LIC.PRANIM TEKNIK TE LOKALIT	1,000.00	1,825.00	182.50	82.50
<b>65015 - SHËRBIMET KADASTRALE-LIPJAN</b>	0.00			
50017 - TAX VERIFIKIM DOK.TË NDRYSHME	20,139.00	19,400.00	96.33	-3.67
50011 - TAX REGJISTRIMIN E TRASHIGIMIS	14,166.50	14,184.00	100.12	0.12
50504 - TAX PER MATJEN TOKES NE TEREN	9,831.75	8,204.60	83.45	-16.55
<b>66320 - PLANIF.URBAN.INSPEKC.-LIPJAN</b>	0.00			
50009 - TAX PËR LEJE NDËRTIMI	62,334.68	106,283.77	170.51	70.51
50012 TAX NDERRIMI DESTINIMI I TOKES	25,662.25	16,345.00	63.69	-36.31
50026 - TAX PER LEGALIZIMIN E OBJEKTE.	13,081.80	0.00		
Taksë për rrenimin e objekteve	0.00	3,782.50		
<b>18163 - INFRASTRUKTURA PUBLIKE</b>	0.00			
50405 - SHFRYTEZIMI I PRONES PUBLIKE	0.00	940.00		
50406 - PRONA PUB.PER TREG.TE HAPUR	8,679.00	12,318.80	141.94	41.94
<b>85003 - SHËRBIMET KULTURORE-LIPJAN</b>	0.00			
50019 - TAX TJERA ADMINISTRATIVE (RHIVA)	164.50	94.00	57.14	-42.86
50408 - QIRAJA NGA OBJEKTET PUBLIKE	86.40	0.00	0.00	-100.00
<b>GJITHESEJT I:</b>	390,971.73	411,057.66	105.14	5.14
92250 - ARSIMI PARAFI & QERDHJA-LIPJAN	9,794.50	10,610.00	108.33	8.33
73200 - SHËRBIMET E KUJDESIT PRIMAR SHËNDETESIA 73200- 50409	12,426.60	9,828.50	79.09	-20.91
50403 - TE HYRAT NGA SHITJA E MALLRAVE (PARTICIPIM) A.GLLAVICA	1,026.50	1,035.00	100.83	0.83
50408 - QIRAJA NGA OBJEKTET PUBLIKE	0.00	0.00		
50409- SHKOLLA E MESME ULPIANA	0.00	10.00		
<b>GJITHESEJT II:</b>	414,219.33	432,541.16	104.42	4.42
GJOBAT E TRAFIKUT	6,440.00	10,060.00	156.21	56.21
GJOBAT E GJYKATES	15,415.00	5,060.00		
AGJENCIONI I PYJEVE	0.00	0.00		
<b>GJITHESEJT III:</b>	436,074.33	447,661.16	102.66	2.66
DONACIONET	13,500.00	58,683.00	434.69	334.69
<b>GJITHESEJT IV:</b>	449,574.33	506,344.16	112.63	12.63

## Sektori i Tatimit në Pronë

Ligji mbi faljen e borgjëve nuk është duke dhënë rezultatet e pritura. Shumë pak të hyra janë gjeneruar nga ky Ligj.

Sektori i Tatimit në pronë është duke u ballafaquar me probleme dhe josaktësi në gjenerimin e raporteve nga Sistemi elektronik i Tatimit në Pronë. Ministria e Fiancave është njoftuar për këto probleme dhe janë duke punuar në këtë drejtim.

Me kërkesën e menaxhmentit, Sektori i Tatimit në Pronë ka nxjerrë Listen e tatimpagueseve të cilët nuk kanë paguar tatimin në pronë, listën e stafit politik duke filluar nga Kryetari i Komunës, listën e punetorëve të administratës, punetorëve të arsimit, punetorëve të shëndetësisë.

Të gjitha keto lista do të publikohen në webfaqen e Komunës dhe secili borgjli do të kontaktohet personalisht. Në rast të dështimit ne do të fillojmë me dorëzimin e vërejtëjëve të para.

Gjatë kësaj periudhe në Zyrën e Tatimit në Pronë janë tërhequr 2950 fatura për kryerjen e shërbimeve të ndryshme nga tatimpaguesit.

Me qëllim të regjistrimit të veturave janë lëshuar 850 certifikata. Për të kryer ndonjë shërbim në kadastër dhe për humbje të nënshtetësisë janë lëshuar 392 certifikata.

Janë lidhur katër marrëveshje për pagesën e tatimit në pronë me këste dhe janë regjistruar dy kontrata të shitblerjes në programin e tatimit në pronë.

Në terren janë regjistruar 32 objekte të reja, 5 objekte afariste, janë modifikuar 5 objekte tjera dhe janë verifikuar 89 objekte të cilat nuk kanë pasur ndryshim.

Bazuar në kërkesën e pranuar nga MF, Drejtorati për Buxhet dhe Financat ka filluar përgaditjet për ekzpozitën e vlerësimit të tokave e cila do të mbahet më 31.05.2017 në ora 09:30 në Lipjan.

## Sektori i Thesarit

Gjatë kësaj periudhe kohore në Sektorin e Thesarit janë pranuar dhe janë kryer gjithsejtë: 258 lëndë në shumë prej 276,302.01€. Të gjitha këto lëndë janë bërë shpenzim; janë certifikuar, aprovuar në SIMFK pastaj janë regjistruar dhe i janë dorëzuar zyrtarit të arkivit për arkivim dhe fotokopjim, Ecuria e Shpenzimeve në bazë të kategorive ekonomike e shprehur në shumë dhe përqindje duke përjashtuar kategorinë ekonomike të pagave dhe mëditjeve pasi që këto lëndë procedohen në Ministrinë e Administratës Publike duket kështu:

• Mallra e Shërbime .....	140 lëndë në shumë prej:	43,086.24 € ose	15.59 %
• Komunali .....	83 lëndë në shumë prej:	23,178.83 € ose	8.39 %
• Subvencione dhe Transfere.....	26 lëndë në shumë prej:	20,030.00 € ose	7.25 %
• Investime Kapitale.....	9 lëndë në shumë prej	190,006.94 € ose	68.77 %
<b>Totali i Shpenzimeve në këto kategori ekonomike:.....</b>		<b>276,302.01 € ose</b>	<b>100% .</b>

Gjatë kësaj periudhe kohore janë ekzekutuar:

- 18 lëndë të vitit 2016 në shumë 8,615.33 €
- 240 lëndë të vitit 2017 në shumë 276,683.68 €

Zyrtari Arkivues ka pranuar dhe arkivuar 258 lëndë si dhe ka bërë shkarkimin e 32 lendeve për asete të demoluara.

## Regjistrimi i Pasurisë Komunale

Gjatë kësaj periudhe raportuese është bërë njoftimi i zyrtarëve me asetet të cilat i posedojnë duke i dërguar gjendjen e shtypur. Me qëllim të lehtësimit të menaxhimit të pasurisë komunale dhe lehtësimit të inventarizimit, secilit zyrtar të ngarkuar i është kërkuar ta vendosin listen e inventarizimit në një vend të dukshëm. Poashtu, gjatë kësaj jave është bërë monitorimi i vendosjes së këtyre listave. Shumica e zyrtarëve kanë vendosur listat në vende të dukshme në zyret e tyre.

Zyrtari i pasurisë ka bërë regjistrimin e pasurisë kapitale në SIMFK ,E-pasuri. Janë regjistruar dy projekte kapitale asfaltimi i rrugës në Fshatin Vrellë dhe hapja dhe zgjerimi i lumenjeve në disa fshatra.

Në kategorinë e pasurisë jo kapitale është regjistruar furnizimi me material për Drejtoriatin e Shëndetësisë.